




Raport Studimor

“Fëmijët Jashtë Kujdesit Prindëror”, për vitin 2012-Qarku Durrës



Qarku
Durrës

Eksperti Rajonal
Elda Beqiri
Prill 2014

LISTA SHKURTIMEVE

VKM - Vendime te Këshillit të Ministrave

Observatori - Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Durrës

NJDF - Njësia për të drejtat e fëmijëve

DAR - Drejtoria Arsimore Rajonale

DSHP - Drejtoria e Shëndetit Publik

DP - Drejtoria e Policisë

DRSHSSH - Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

UNICEF - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

PLM - Shkolla për fëmijë me prapambetje të lehta mendore

I-Parathënie dhe falenderime

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve është një strukturë e shoqërisë civile e ngritur dhe fuqizuar nga UNICEF-Shqipëri. Observatori ka filluar të funksionojë në Mars të vitit 2009. Tashmë Observatori ka ngritur zyrat në rang kombëtar në të 12-të qarqet e Shqipërisë.

Në punën e tij observatori kërkon të ndërgjegjësojë shoqërinë shqiptare në lidhje me detyrimet e lindura në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Ky ndërgjegjësim ndër të tjerash mbështet dhe në raportet dhe informacionet që përcjellin analizën e të dhënave dhe të informacioneve të ndryshme, takime dhe vëshgime të realizuara drejtëpërsëdrejti nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Qarku Durrës.

Në Qarkun e Durrësit, Observatori ushtron veprimtarinë e tij që prej vitit 2009 ku ky Qark ishte një ndër 3 qarqet e para që u bë pjesë e nismës së UNICEF për ngritjen e këtyre strukturave në të gjitha qarqet e Shqipërisë.

Observatori Durrës konsiderohet tashmë një partner i rëndësishëm në nivel lokal e rajonal. Që prej vitit 2009, Observatori ka realizuar 23 marveshje bashkëpunimi, ku ndër të tjera ka kontakte dhe ruan marrëdhëniet e komunikimit dhe shkëmbimit të informacioneve edhe me organizatat e shoqërisë civile në qark dhe kryesisht të rrethit durrës, dhe jo vetëm por shpesh janë bërë pjesë e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Bashkëpunimi me njësitë vendore (Komuna e Bashki) ka qënë i suksesshëm jo vetëm në nënshkrimin e marveshjes së bashkëpunimit por dhe në komunikimin e rregullt dhe të dyanshëm të shkëmbimit të informacioneve dhe pjesmarrjes në aktivitete.

Si pjesë të suksesshme të Observatorit do të citohej edhe bashkëpunimi i ngushtë që ka me institucionet si: Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Qark dhe Bashki, Sherbimin Social Shtetëror, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Policisë, dhe veçanërisht Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës.

Për hartimin e këtij raporti studimor në lidhje me "Fëmijët jashtë kujdesit prindëror", falenderojmë Drejtuesen e Shtëpisë së Foshnjës Znj. Ina Duka, Psikologjen e Shtëpisë së Foshnjës Znj. Daniela Deliallisi, Znj. Marjana Biba Kryetare e Shoqatës së Jetimëve, Znj. Valmira Greca e Shërbimit Social Shtetëror për bashkëpunimin në hartimin e këtij raporti.

Një falenderim shkon për stafin drejtues të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve znj. Elma Tërshana (Drejtore Projekti), znj. Mina Mata (Administratore Kombëtare për të dhënat),

znj.Ermira Zaçe (Administratore dhe financiere), për mirëkuptimin dhe suportin që kanë dhënë gjatë realizimit të studimit

II-Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë situatën e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror për vitin 2012 në Qakun e Durrësit, nëpërmjet analizës së standarteve kryesore të shërbimit të përkujdesjes dhe zbatimit të tyre. Ky studim evidenton disa nga problematikat që ndeshen gjatë zbatimit në praktikë të standarteve, si dhe jep sugjerime për përmirsimin e mëtejshëm të standarteve, për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror.

Realizimi i këtij studimi synon të nxjerrë në pah pothuajse të gjitha problematikat e fëmijëve që jetojnë në institucione të përkujdesit dhe janë pa kujdes prindëror.

Objektivat e këtij studimi janë:

-Të përshkruaj dhe vlerësojë cilësinë në institucionet e kujdesit social për fëmijët jashtë kujdesit prindëror.

-Të vlerësojë situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe zhvillimin psiko-social të fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale të kujdesit social.

-të evidentojë problemet dhe bëjë rekomandime lidhur me sistemin e kujdesit social për fëmijët jashtë kujdesit prindëror.

Ky raport mund të shërbejë **Qendrave Rezidenciale për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, Bashkive dhe komunave ku ndodhen këto qendra**, si dhe të gjithë **Bashkive e komunave të Qarkut Durrës**. Gjithashtu ky studim do të shërbejë dhe **donatorëve të ndryshëm dhe personave të tjerë të interesuar** për të përmirësuar situatën e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror, duke **synuar integritet** të plotë të këtyre fëmijëve në jetën sociale.

Realizimi i studimit “Situata e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror” për vitin 2012 u realizua në nivel qarku, por i fokusuar kryesisht mbi rrethin Durrës pasi këtu kemi institucionin rezidencial dhe ditore për fëmijët jetim quajtur ndryshe Shtëpia e Foshnjës me kapacitet 30 fëmijë, dhe gjithashtu në rrethin Durrës janë përqendruar pjesa më e madhe e shoqatave që kanë në fokus të tyre fëmijët ashtu siç është dhe shoqata e jetimëve në Durrës.

Target grupi i përzgjedhur për këtë studim janë të gjithë fëmijët jashtë kujdesit prindëror, të moshës 0-18 vjeç, në të gjitha qendrat ditore e rezidenciale dhe jashtë tyre.

1. Metodologjia e studimit.

Metodologjia e studimit e perdorur për këtë studim është: shqyrtimi i të gjitha raporteve, dokumenteve strategjike kombëtare dhe lokale, shqyrtimi i ligjeve ne fuqi, intervista me aktorë të ndryshëm kyç të institucioneve lokale, si dhe intervistimi i disa fëmijëve që jane pjesë e institucioneve të përkujdesit shoqëror.

Shqyrtimi i legjislacionit dhe politikave aktuale:

U realizua një analizë e politikave lokale si dhe e kuadrit aktual ligjor që mbështet përkujdesin social në Shqipëri, u shqyrtua kodi familjes dhe disa ligje që lidhen me birësimin dhe arsimin.

Ligjet që u morën në shqyrtim jane: Ligji nr.9695 date 19.03.2007 “Për procedurat e birësimin dhe Komitetin Shqipëtar të Birësimeve”, VKM për kujdestarinë e fëmijëve nr. 752 datë 08.09.2010.

Ligji-Nr-10-347-datë-4-11-2010 “Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

Strategjitë lokale dhe kombëtare e raporte, që u analizuan për qëllim të këtij studimi kryesisht janë:

Plan veprimi për fëmijët 2012-2015

Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale 2007-2013

Strategjia e përfshirjes sociale 2007-2013

Raporti Vjetor Për Veprimtarinë e Avokatit të Popullit 2012

Gjithashtu u realizuan një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve të ndryshme lokale si : Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, Shërbimi Social Bashki.

Qendra rezidenciale dhe ditore për fëmijë në Qarkun Durrës, Shoqata e Jetimëve Durrës, si dhe informacione të mbledhura nga vetë Observatori.

U hartua dhe u shpërnda një pyetsor me 18 pyetje drejtuar institucionit rezidencial quajtur ndryshe “Shtëpia e Foshnjes” si dhe një prej qëndrave ditore. (**Aneks 1-Pyetsori**)

Pjesë e studimit të këtij raporti është takimi me 3 fëmijët jashtë kujdesit prindëror që ndjekin arsimin e detyruar dhe që frekuentojnë qendrën ditore Durrës.

Realizimi i këtij studimi pati vështirësit dhe limitizimet e tij si më poshtë:

1. Pamundësia për të realizuar takime apo kontaktuar në telefon me komunat dhe bashkitë si rezultat i mungesës së buxhetit, dhe si rezultat komunikimi është realizuar vetëm nëpërmjet postës.
2. Po për arsye të mungesës së buxhetit ishte e pamundur realizimi i vizitave nga afër në qendrat ditore që ndodhen në rrethin Krujë si dhe për të realizuar fokus grupe.
3. Vështirësi u hasën edhe në marrjen e të dhënave statistikore për shkak të një situatë jo pozitive brënda institucionit që ka të bëjë me lëvizjet e mundëshme në staf.

III-Analiza e studimit

Qyteti i Durrësit ka një pozitë rajonale gjeografike strategjike të favorshme, përmes pikave me vlerë të madhe territoriale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai zë një pozitë gjeografike kyçe për të gjithë vëndin, gjë që e favorizon qarkun e Durrësit të jëtë qyteti i dytë në Shqipëri për nga zhvillimi ekonomik-social. Gjithashtu është një ndër qarqet më të mëdha me një popullsi prej 416518 banorë, me një numër të përgjithshëm familjesh prej 105261 familje, nga të cilët fëmijë të moshës 0-18 vjeç janë 113811 fëmijë, të cilët përbëjnë 27% të popullsisë të qarkut të Durrësit.

Sipas Kodit të Familjes neni 263 Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, ose janë shpallur si të pagjetur, ose u është hequr përgjegjësia prindërore, ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

Quhen fëmijë jashtë kujdesit prindëror fëmijët prindërit e të cilëve kanë vdekur, i është hequr kujdesi prindëror, janë braktisur, prindërit janë të paafhtë për kohësisht ose të përhershëm të kujdesen për fëmijët e tyre, fëmijët janë vendosur në institucionet për fëmijë nga shërbimet sociale¹.

¹ Përkufizim (nga botimi i vitit 2010, E Drejta Familjare, Sonila Omari).

Target grupi i këtij studimi janë fëmijët jashtë kujdesit prindëror të moshës 0-18 vjeç, evidentimi i tyre si ato në institucione edhe ato jashtë institucioneve, ku evidentimi i fëmijëve jashtë kujdesit prindëror jashtë institucioneve është më i vështirë për të marrë shifra të sakta dhe marrja e të dhënave mbi këto fëmijë është bërë e mundur vetëm nëpërmjet bashkëpunimit me Shoqatën e Jetimëve Durrës.

Në qarku e Durrësit janë ngritur dhe funksionojnë institucione me shërbime për fëmijë. Këto institucione janë:

Institucione Rezidenciale për Fëmijë

- Shtëpia e foshnjes Durrës me kapacitet 30 fëmijë,por aktualisht ka 19 fëmijë.
- Qendra e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar e cila ka një kapacitet prej 44 fëmijë.

Institucione Rezidenciale jo publike për fëmijë

- Shtëpia e Fëmijëve “Betania” në Bubq
- Shtëpia e fëmijëve” Shtëpia Ortodokse e shpresës” në Shënvllash me kapacitet 25 fëmijë.
- Shtëpia e fëmijëve “Brezi i Zgjedhur”, në Thumane

Qendra ditore publike për fëmijë

- Qendra ditore e shtëpisë së foshnjes me 30 fëmijë nga familje me probleme social ekonomike.

Qendra jopublike për fëmijë

- Qendra ditore për fëmijë “Dielli i Mëngjesit”, me kapacitet 15 fëmijë
- Qendra ditore për fëmijë e fondacionit “Qendra Kristiane e Durrësit” me kapacitet 50 veta
- Qendra ditore për fëmijë e fondacionit NEHEMIA me kapacitet 60 fëmijë
- Qendra ditore për fëmijë “Sot për të ardhmen”
- Qendra ditore për fëmijë “Lulet e Fushes” në Maminas me kapacitet 50 fëmijë

Shtëpia e foshnjës është një institucion shtetëror i mbështetur nga bashkia Durrës ku në vitin 2005 u ndërtuan casa familjet dhe në vitin 2010 u realizua rikonstruksioni i plotë i saj, e cila mirëpret fëmijë jo vetëm nga qarku Durrës por edhe nga të gjithë qarqet e Shqipërisë.

Tabela 1: Numri i fëmijëve në shtëpinë e foshnjes Durrës për vitin 2012

Burimi: Institucioni rezidencial “Shtëpia e Foshnjes” Durrës, Dhjetor 2013

Sipas grupmoshës	Institucioni Rezidencial
0-3 vjeç	9 Fëmijë
3-6 vjeç	9 Fëmijë
6-14 vjeç	-
Mbi 14 vjeç	1 Fëmijë
Sipas Gjinisë	
Meshkuj	10
Femra	9
Romë/Egjiptian	7

Ashtu si në qendrën rezidenciale edhe në qendrën ditore fëmijët janë të pajisur me dosjen përkatëse. Nga 19 fëmijë që ndodhen në qendrën rezidenciale, 15 prej këtyre fëmijëve janë fëmijë të braktisur nga prindërit dhe pjesa tjetër janë fëmijë me interesim por qëndrojnë për arsye se familjet nuk kanë gjëndjen ekonomike. Fëmijët qëndrojnë në këtë institucion deri sa të bëhet birësimi i tyre dhe moshë e preferuar për birësim është 0-6 vjeç. Në rast se fëmijët nuk birësohen dhe mbushin moshën 14 vjeç ato kalojnë në institucione të tjera dhe kur mbushin moshën 18 vjeç shkojnë në konvikte ku duhet të përballojnë vetë jetesën.

Numri i fëmijëve të larguar nga kjo qendër është 9 fëmijë të moshës 0-3 vjeç të cilët janë larguar për arsye birësimi, ose janë kthyer në familje biologjike.

Fëmijët rezidencial që janë me interesim prindëror, prindërit nuk interesohen aq sa është e nevojshme për fëmijët që të kenë një lidhje frytdhënëse për të dyja palët dhe as për ecurinë e fëmijëve, por ata thjesht vijnë e i takojnë fëmijët si procedurë që duhet bërë. Është vetë institucioni që informon prindërit për ecurinë e fëmijëve dhe i krijon atyre një ambient të përshtatshëm, madje punon me secilin individë (prind, fëmijë) në mënyrë individuale.

Për sa i takon fëmijëve që largohen nga qendra pra që birësohen, qendra i përgatit këta fëmijë nga gjëndja psikologjike dhe emocionale, gjithashtu fëmijët monitorohen si përpara por edhe pas largimit të tyre nga qendra.

Stafi tregon kujdes për sa i takon veshjes duke ndihmuar dhe këshilluar fëmijët se si duhet të vishen, madje tregon kujdes mbi etikën e të ushqyerit ku vetë stafi shoqëron fëmijët në tavolinë duke i treguar atyre se si funksionon një familje dhe çdo të thotë ajo. Tregohet kujdes në përzgjedhjen e ushqimit sipas nevojave dietike të fëmijëve.

Tabela 2: Kapaciteti akomodues i qendrës rezidenciale

Burimi: Qendra rezidenciale “Shtëpia e Foshnjes” Durrës

	Kapaciteiti akomodues	Numri i fëmijëve të trajtuar për vitin 2012
Shtëpia e foshnjes Durrës	30 shtretër	19 fëmijë

Numri i fëmijëve për dhomë është 4 fëmijë

Tabela 3: Numri i fëmijëve në qendrën ditore të shtëpisë së foshnjes Durrës

Burimi: Shtëpia e foshnjes Durrës

Sipas Grupmoshës	Ditor
0-3 vjeç	-
3-6 vjeç	30 fëmijë
6-14 vjeç	-
Mbi 14 vjeç	-
Sipas gjinisë	
Meshkuj	18 fëmijë
Femra	12 fëmijë
Romë/Egjiptian	5 fëmijë

Këta fëmijë janë vetëm të lagjes ku ndodhet Shtëpia e Foshnjes, dhe janë fëmijë që vijnë nga familje me probleme të theksuara ekonomike e qëndrojnë aty deri kur mbushin moshën për në shkollë.

Si të gjithë fëmijët edhe këta fëmijë gëzojnë të drejtat e tyre si:

- Fëmijët vendosen në këto institucione vetëm nëse kjo zgjedhje përkon me plotësimin e të drejtave dhe nevojave të tyre.

- Këtyre fëmijëve edhe pse janë larguar nga prindërit e tyre duhet ti sigurohen kontakte të rregullta me prindërit e tyre.
- Fëmijët jashtë kujdesit prindëror, të cilët janë motra dhe vëllezër, kanë të drejtë të qëndrojnë bashkë në të njëjtin institucion dhe nëse nuk është e mundur tu sigurohen kontakte të rregullta me prindërit e tyre
- Të drejtën për tu respektuar dinjitetin e tyre
- Të drejtën për respektim të përkatësisë etnike, kulturore, fetare e gjuhësore
- Të drejtën e respektimit të jetës private dhe intimitetit të tyre gjatë jetës në institucion
- Të drejtën e një përkujdesje shëndetsore cilësore
- Të drejtën për mundësi të barabarta arsimimi, përkujdesje shëndetsore, kualifikim profesional, gatë jetës së tyre kolektive.
- Të drejtën për të pasur qasje në të gjitha llojet e shkollimit, trajnimit apo kualifikimit profesional
- Të drejtën e pjesëmarrjes dhe vendimarrjes lidhur me kushtet e jetesës së tij në institucion
- Të drejtën për tu informuar lidhur me të drejtat që ai ka dhe rregullat në institucionet e përkujdesjes

E Drejta për Arsim

Ligji Nr. 10347 datë 4.11.2010-Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, neni 16 sanksionon të drejtën për arsim:

Fëmija ka të drejtë të arsimohet në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor dhe fizik të tij.

Tabela 4:Nr i shkollave dhe nxënësve

Burimi: DAR Durrës

Emërtimi	Nr.shkollave 9-vjeçare publike e private	Nr shkollave të mesme publike e private	Nr. Nxënësve gjithsej në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme	Nr. I nxënësve që kanë braktisur shkollën
Rrethi	84	35	41520	224

Nga kontaktimi me specialistë të statistikave të Dar Durrës bëhet i ditur informacioni i paraqitur në tabelën e mësipërme ku siç shikohet 224 nxënës kanë braktisur shkollën për vitin 2012 në nivel qarku. Komunitat apo bashkitë e rrethit nuk bëhen të ditura por nga komunikimi me Dar

arsyet e braktisjes së shkollave janë gjëndja jo e mirë financiare e familjeve, si dhe distancat e largëta të shkollës nga vendbanimi. Pjesë e analizës së ngritur është dhe identifikimi i raportit të fëmijëve pa kujdes prindëror që kanë braktisur shkollën. Paraqitjen me numra dhe përqindje se sa fëmijë pa kujdes kanë braktisur shkollën, ishte e vështirë për vetë faktin se të dhënat e ofruara nga Institucionet arsimore në Qarkun e Durrës, ofrojnë të dhëna në nivel Rrethi, gjë e cila e bën të pamundur identifikimin apo qasjen e problemit të braktisës për target grupe të ndryshme fëmijësh.

Për sa i takon fëmijëve jashtë kujdesit prindëror është një e dhënë, një shifër që vetë Drejtoria Arsimore nuk e mbledh për çdo shkollë, edhe pse në regjistrat përkatëse të çdo klase kujdestari mbahen evidenca kur fëmijët nuk i kanë prindërit apo kur nuk kanë njërin prej tyre.

Nga regjistrimi i fëmijëve në Shoqatën e Jetimëve Durrës rezulton se 1257 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor dhe të detyruar përkatësisht fëmijë të moshës 0-14 vjeç, të cilët janë fëmijë jetim me një prind por edhe fëmijë me statusin e jetimit, pra pa asnjë prej prindërve si dhe fëmijë që jetojnë në familje kujdestare.

Gjithashtu një numër të konsiderueshëm të regjistruar në shoqatën e jetimëve zënë edhe fëmijët e moshës 15-18 vjeç, përkatësisht 517 fëmijë të cilët ndjekin arsimin e mesëm.

Ndërsa për sa i takon fëmijëve që evidentohen në qendrat rezidenciale ata nxiten të arsimohen dhe ndihmohen nga vetë stafi dhe punonjësi social për integrimin e fëmijëve në kopshte dhe shkolla.

Madje atyre i vendoset në dispozicion biblioteka dhe pajisjen me mjete mësimore.

Kjo kategori fëmijësh nuk has vështirësi në pranimin e tyre në shkolla por niveli i mësimnxënies së tyre është i ulët².

Problem madhor ngelet mungesa e bursës shkollore për fëmijët jashtë kujdesit prindëror si pasojë e mos verifikimit të dokumentacionit nga instancat përkatëse dhe kryesisht shteti nuk ofron mbështetje për ata individë që mbarojnë arsimin e mesëm dhe duan të ndjekin arsimin e lartë.

Fëmijët që mbushin moshën 18 vjeç u duhet të largohen nga institucionet përkatëse dhe të mund të përballojnë vetë jetesën e tyre, gjë që bën të pamundur përballimin e kostos së ndjekjes së arsimit të lartë nga ana e tyre dhe jo pa arsye kjo kategori është një ndër kategorit me nivel më të ulët arsimor, madje që kanë edhe probleme të ndryshme social-ekonomike.

² Nga biseda me psikologun e shkolles 9-vjeçare Eftali Koçi, mungesa e mësimnxënies vjen si pasojë e mungesës së familjes apo të një familje “të shëndoshë”.

Janë një sërë faktorësh që pengojnë realizimin e përshtatshëm të të drejtave të fëmijës për të jetuar, për tu zhvilluar e mbrojtur, si dhe për t'u këshilluar me ta kur merren vendime që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre si:

- Mungesa e një legjislacioni të plotë
- Mangësitë e shërbimeve sociale të ngritura mbi bazë komuniteti
- Modeli i papërshtatshëm i përkujdesjes dhe pamjaftueshmëria e shërbimeve sociale
- Largimi nga përkujdesi në moshë të hershme dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse
- Mos koordinimi i aktivitetit të strukturave të kujdesit në nivel kombëtar dhe lokal
- Mos trajtimi si prioritet në politikat dhe strategjitë kryesore. Po ashtu dhe fakti që politikat dhe strategjitë kombëtare janë fragmente dhe nuk japin një zgjidhje të fenomenit në tërësi.
- Sigma nga shoqëria duke i etiketuar ata si të këqinj, si të pandreqshëm, dhe dembel është një tjetër pengesë për këtë kategori sociale.

E Drejta për Mbrojtje Sociale

Ligji Nr.10347 datë 4.11.2010-Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës neni 20. sanksion të drejtën për mbrojtje sociale:

- 1.Fëmija ka të drejtë të përfitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet prindit/përfaqsesit ligjor, mbrojtje sociale, përfshirë dhe sigurimet shoqërore.
- 2.Mbrojtja kur është e nevojshme duhet të jepet, duke pasur parasysh të ardhurat e kushtet e fëmijës e të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë, të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Koncepti i Familjes Kujdestare gjithashtu është një koncept i ri i futur në legjislacionin shqiptar (neni 266 i KF) si një familje alternative nga ajo e origjinës për të miturit jashtë kujdesit prindëror. Në kuptim të ligjit (neni 266 KF) familja kujdestare përkufizohet si: *“një familje alternative e vendosur nga gjykata për të ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale”*

Vendosja e të miturit në një familje antarët e të cilëve nuk kanë lidhje gjaku apo gjinie me të miturit mund të përbëjnë ambientin e duhur familjar për atë kohë sa familja apo prindërit e tyre të zgjidhin problemet.

Në bazë të Ligjit Nr.9355 datë. 10.03.2005 Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore, neni 5, pika 2, sanksionon se:

“Përfitues të ndihmës ekonomike janë jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari”.

Tabela 5: Nr, familjeve si dhe nr fëmijëve që drejtohen nga kryefamiljare femra
Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

	Nr. Familjeve me fëmijë 0-18 vjeç Viti 2011	Nr. Familjeve me fëmijë 0-18 vjeç Viti 2012	Nr. I fëmijëve 0-18 vjeç që drejtohen nga kryefamiljare femra, viti 2011	Nr fëmijëve 0-18 vjeç që drejtohen nga kryefamiljare femre, viti 2012
Rrethi Durrës	670	556	205	156
Rrethi Krujë	555	525	47	81
Qarku Durrës	1225	1081	252	237

Ajo që bjen në sy nga tabela e mësipërme janë ndryshimet e theksuara në shifra të familjeve që kanë dal apo kanë hyrë në skemat e ndihmës ekonomike.

Pra siç shikohet numri i familjeve me fëmijë 0-18 vjeç në nivel qarku ka një diference prej 144 familje të dala nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2012. Po ashtu shikohet një ulje në nivel qarku nga viti në vit i fëmijëve 0-18 vjeç që drejtohen nga kryefamiljare femra, por për sa i takon rrethit të Krujës vërehet se ka një numër më të lartë të fëmijëve 0-18 vjeç që drejtohen nga kryefamiljare femra për vitin 2012, pra fëmijë jetim me një prind.

Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 787, datë 14.12.2005, Për Përcaktimin e Kriteve të Proedurave dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike:

Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim të përcaktuar nga ligji është 3.000 (tre mije) lekë në muaj.

Masa e plote e ndihmës ekonomike pavarësisht nga përbërja e familjes nuk mund të jetë më e lartë se 7000 (shtate mije) lekë në muaj.

Gjithashtu masë të ndihmës ekonomike marrin edhe kujdestarët e fëmijëve jetim, por ngelet problem mos marrja e plotë e shumës së akorduar për ta, shqetësim ky i ngritur nga vetë kujdestarët pranë Shoqatës së Jetimëve Durrës.

E Drejta për Kujdes Shëndetsor

Ligji Nr.10347 datë 4.11.2010 Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, neni 19 E Drejta për Kujdes Shëndetsor, sanksionon:

- 1.Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetsor të përshtatshëm dhe për përfitim nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit.
2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet në veçanti, duke marrë masa:

- a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijore
- b) për ti siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjeksore e kujdesin për shëndetin, duke vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetsor parësor.
- c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerje dhe në kuadrin e kujdesit shëndetsor parësor, me anë të sigurimit ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshëm dhe të ujit të pijëshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror.
- ç) për tu siguruar nënave kujdesin shëndetsor para dhe paslindjes
- d) për të mundësuar që të gjitha grupet shoqërore dhe në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit të femijes, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjën e përmirësimit të mjedisit, dhe parandalimin e aksidenteve
- dh) për të zhvilluar kujdesin shëndetsor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar

Tabela 6: Vdekshmëria Foshnjore

Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik

Rrethi Durrës	Viti	Vdekshmëria foshnjore 0-1 vjeç për 1000 lindje të gjalla	Vdekshmëria foshnjore 0-5 vjeç për 1000 lindje të gjalla
	2011	4.10	8.8
	2012	6	6.4

Pra siç shikohet nga të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Shëndetit Publik në vitin 2012 kemi rritje të numrit të vdekshmërisë foshnjore 0-1 vjeç për 1000 lindje të gjalla që shkon në shifrën 6 dhe ngelet problematike. Megjithëse ky tregues nuk targeton fëmijët jashtë kujdesit prindëror, kjo e dhënë është bërë pjesë e këtij raporti për të nxjerr në pah një nga problemet që Observatori vëren në terren, siç është rritja e vdekshmërisë foshnjore dhe fëmijore për rrethin e Durrësit nga viti 2011 në vitin 2012.

Të gjithë fëmijët qoftë apo jo jetim marrin kujdes shëndetsor falas pranë qendrave shëndetsore të çdo lagje ku fëmija është rezident. Nga mosha 0-14 vjeç fëmijët ndiqen nga mjeku pediatër i lagjes si dhe nga konsultori i fëmijëve të cilët kujdesen mbi vaksinimin e rregullt dhe në kohë të fëmijëve, gjithashtu ofrojnë konsulta për sa i takon mirërritjes së fëmijës.

Në lidhje me fëmijët jetim të qendrës rezidenciale të shtëpisë së foshnjes, kanë në përkujdesje të tyre një infermiere, pra e punësuar në qendrën rezidenciale por nuk kanë një mjek në këtë qendër. Kur fëmijët sëmurën apo kanë nevojë për vizita ata shoqërohen nga vetë stafi tek mjeku i lagjes së asaj qendre shëndetsore ku ndodhet fizikisht kjo qendër, madje në orët e vona kur nuk

ka më shërbim në qendrat shëndetsore të lagjes, atyre iu është dashur ti dërgojnë fëmijët në spitalin qendror të rrethit të Durrësit.

Vetë stafi kujdeset për higjenën e këtyre fëmijëve, qoftë duke mbajtur ambientet e pastra por edhe në kujdesin e higjenës personale të fëmijëve. Ata i mësojnë fëmijëve se si të kujdesen për vete dhe gjithashtu kujdesen që fëmijët të konsumojnë vakte të shëndetshme dhe dietike në bazë të nevojave që ka cdo fëmijë.

Problem tjetër madhor veç faktit që në qendër nuk ka mjek, ngelet dhe mungesa e fondeve për të përballuar veshmbathjen e fëmijëve.

Grupmosha 18-25 vjeç të cilët kanë përfituar statusin e jetimit hasin vështirësi në marrjen e shërbimit spitalor falas pasi nuk u njihet statusi i jetimit, edhe pse përfitojnë shërbimin ambulant falas.

Pjesmarrja në vendimarrje

Për sa i takon pjesmarrjes së fëmijëve në marrjen e vendimeve ajo ngelet e kufizuar.

Një ndër objektivat strategjike e së drejtës për arsim është dhe rritja e pjesmarrjes së fëmijëve në procesin vendimarrës në shkollë dhe jashtë saj, e cila kushtëzohet nga objektivat:

- I. Pjesëmarrje e vazhdueshme dhe cilesore e fëmijëve në vendimarrjet për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor, si dhe në veprimtaritë brënda dhe jashtë shkollës.
- II. Promovimi i të drejtave të fëmijëve.

Dhe arritja e këtyre objektivave kërkon:

-Informimin dhe marrjen e vendimeve sëbashku me trupin pedagogjik

-Marrjen e përgjegjësisë kundrejt vetvetes, shkollës, familjes, komunitetit.

-Praktikimit të formave të delegimit dhe përfaqësimit

-Pjesëmarrjen në këshillat drejtues të shkollës si edhe monitorim të zgjedhjes dhe të funksionimit të qeverisë së nxënësve.

Përsa i takon këtyre objektivave qëndrojnë në mënyrë formale, dhe në mënyrë konkrete lënë për të dëshiruar.

Buxheti i shpenzuar në Qarkun Durrës për vitin 2012,2013

Në lidhje më buxhetin për vitin 2012 Observatorit i është bërë i ditur vetëm shuma totale e këtij viti e cila është 142288 lekë si dhe shuma totale e vitit 2013 e cila është 118711 lekë, por pa mundur të specifikohen zërat e këtij buxheti. Ajo që bie në sy nga totali i dy viteve është diferenca prej 23577 lekë nga viti në vit, dhe kjo tregon ulje të mirqënies ekonomike të rajonit.

Nga bisedat dhe takimet që ka realizuar observatori në institucione të ndryshme mbetet problematike mungesa e fondeve si nga shteti ashtu edhe nga donatorët, dhe kjo bën që në mënyrë indirekte të shkelen të drejtat e fëmijëve pasi janë pikërisht këto institucione që kujdesen për fëmijët.

Çështje kryesore mbetet dhe strehimi i fëmijëve jetim kryesisht pasi mbushin moshën 18-vjeç dhe duhet të përballojnë vetë jetesën.

Bashkia Durrës ofron shërbimin për të pastrehët por kategoria e jetimëve ngelet gjithmonë në pritje.

Ligjet për fëmijë njihen por jo gjithmonë gjejnë zbatim të plotë, p.sh në rastin e dhënies së kujdestarisë së fëmijës procedurat pengohen nga punonjësit socialë.

Në qarkun e Durrësit nuk janë hartuar dhe zhvilluar politika zhvillimi me fokus fëmijët dhe të drejtat e tyre që prej vitit 2011 i cili korrespondon me mbarimin e Strategjisë Për Fëmijë të hartuar dhe zhvilluar nga Bashkia Durrës.

Iniciativa të rëndësishme me fokus fëmijët janë ndërrmarë edhe nga organizma joqeveritare të cilët kanë hartuar dhe implementuar projekte të ndryshme. Roli i organizatave joqeveritare është i rëndësishëm për sa i takon vënies në “lëvizje” të instucioneve shtetërore si dhe ardhjes në ndihmë të komunitetit në të cilin ato ofrojnë shërbimet e tyre.

Rol të rëndësishëm për sa i takon fëmijëve jetim ka Shoqata e Jetimëve Durrës e cila për shumë vite ka qënë një partnere shumë e mirë dhe bashkëpunuese jo vetëm me organizatat joqeveritare te qarkut Durrës por edhe me institucionet shtetërore duke i ardhur në ndihmë për sa i takon identifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve jetim jo vetëm në qëndrat rezidenciale e ditore por edhe të fëmijëve jetim jashtë këtyre qendrave siç janë fëmijët më një prind apo që jetojnë me gjyshërit.

Numri i organizatave joqeveritare që kanë në fokus fëmijët dhe operojnë në Qarkun Durrës jane rreth 8 organizata, ta cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në lobimin për të drejtat e fëmijëve si dhe duke u gjëndur pranë familjeve të varfëra me fëmijë të grupmoshave të ndryshme.

Puna e ketyre organizatave ka qënë nxitëse dhe këshilluese në marrjen e vendimeve për fëmijët jo vetëm më instancat shtetërore por edhe me partnerë të tjerë të cilët ata bashkëpunojnë.

IV- Gjetje e Rekomandime

Problemi i të miturve është objekt i një vëmendje dhe përpjekje të madhe të shtetit shqiptar i cili në mënyrë të vazhdueshme ka tentuar të përmirsojë shërbimet e përkujdesjes ndaj kësaj kategorie nëpërmjet rritjes së shërbimeve të përkujdesjes si dhe miratimit të legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve. Dhe megjithatë ende ekzistojnë hendeqe të thella si në shërbimet e ofruar ashtu dhe në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të miturve që kërkojnë ndërhyrje me përparësi nga ana e qeverisë dhe autoriteteve publike në këtë sektor. Marrja e masave emergjente si përmirësimi i legjislacionit dhe ndërmarrja e reformave të sistemit gjyqësor dhe atij administrativ, do të ishin tepër të nevojshme për rregullimin sa më efikas të kësaj mardhënie dhe reduktim të ndjeshëm të disa prej problematikave kryesore të ndeshura në realitetin shqiptar lidhur me përkujdesjen ndaj të miturve.

Mbi bazën e hartimit të këtij raporti janë ngritur edhe **rekomandimet** si më poshtë:

1-Fëmijëve jetim të cilët dalin nga institucionet rezidenciale pasi mbushin moshën 18-vjeç tu sigurohet mbështetje e plotë financiare, morale, emocionale, e plotësimin e nevojave të tyre me qëllim integrimin në komunitetin ku do të vazhdojnë të jetojnë.

2-Fëmijët jetim të cilët dalin nga institucionet rezidenciale pasi mbushin moshën 18-vjeç tu sigurohet nga shteti strehimi dhe punësimi.

3-Institucionet dhe shteti të nxisin takimet midis prindërve e fëmijëve që janë me interesim në institucionet rezidenciale duke bërë të mundur kështu që fëmija të kuptojë se ç'është familja dhe përkujdesi.

4-Të punësohet një mjek me orar të plotë në çdo qendër rezidenciale si dhe të realizohen trajnime të stafit.

5-Të ndiqen politika për nxitjen e frekuentimit të shkollës dhe uljen e numrit të nxënësve braktisës.

6-Të shtohen financimet dhe donacionet në qendrat rezidenciale dhe ditore, duke u siguruar atyre më shumë veshmbathje, ushqim, mjete shkollore, lodra dhe aktivitete brënda e jashtë qendrës, sygjeruar këto nga vetë fëmijët e qendrës. Dhe jo vetëm por edhe shoqatave që operojnë në këtë drejtim.

7-Drejtoria Arsimore të bëjë evidentimin e fëmijëve jetim si një statistikë më vete dhe jo vetëm në regjistrat e klasave kujdestari.

- 8-Tu krijohet lirshmëri nxënësve jetim të përfitojnë nga bursat shkollore që ofron shteti.
- 9-Të rishikohet modeli i papërshtatshëm i përkujdesjes dhe pamjaftueshmërisë së shërbimeve sociale.
- 10-Të rishikohet masa e ndihmës ekonomike për fëmijët jetim.
- 11-Të merren masa për uljen e numrit të vdekshmërisë foshnjore e fëmijnore.
- 12-Marrja falas e shërbimeve spitalore për grupmoshën 18-25 vjeç me statusin e jetimit.
- 13-Të mos pengohen e të lehtësohen procedurat në dhënien e kujdestarisë dhe të birësimit të fëmijëve jetim.
- 14-Të hartohen në nivel bashkie/komune por dhe qarku strategji apo plan-veprime me fokus mirëqënien e fëmijëve dhe të drejtat e tyre.

BIBLIOGRAFIA

- Plan Veprimi për Fëmijët 2012-2015, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta
- Protokoll i punës së punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve- në bashkpunim me Terre Des Hommes Misioni në Shqipëri, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, dhe UNICEF, 2010
- Raport Vjetor – Për Veprimtarinë e Avokatit të Popullit 2012
- Analiza e Situatës së Sistemit Mbrojtës së Fëmijëve në Shqipëri 2011-Botim i koalicionit “Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve”
- Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013
- Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale 2007-2013, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë
- Shërbimi i kujdestarisë ndaj të miturve jashtë kujdesit prindëror dhe roli i shtetit shqiptar-Ilda MELO, LL.M
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve Shqipëri
- Ligji Nr. 10347 datë 4.11.2010 Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

- E Drejta Familjare-Sonila Omari, botimi i vitit 2010
- Ligji Nr.9355 datë 10.03.2005, Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.787 datë 14.12.2005, Për Përcaktimin e Kritereve të Proçedurave dhe të Masës së Ndhimës Ekonomike

ANEKSI 1:Pyetsor drejtuar qëndrave rezidenciale dhe ditore në Qarkun Durrës (Dhjetor 2013).

Emri i institucionit :

Drejtuesi:

Vendndodhja:

Datë:

Nr kontakti :

1. Çfarë lloj institucioni është ?

.....

2. Sa është numri i fëmijëve që trajtohen në këtë institucion për vitin 2012 :

Sipas grupmoshës	Rezidencial	Ditor
0-3 vjeç		
3-6 vjeç		
6-14 vjeç		
Mbi 14 vjeç		
Sipas gjinisë		
Meshkuj		
Femra		
Rom/ Egjiptas		
Sipas Statusit:		
I Braktisur		
Jetim		
Etj (specifiko)		

Sipas Kohëzgjatjes në institucion : -më pak se 1 vit -1-2 vjet -me shume se 10 vjet		
Sipas Vendlindjes 1 Durrës 2 3 4 5 6 te huaj		

3. A ka dosje për çdo nga këta fëmijë me vlerësimin e nevojës përkatëse, planin e përkujdesjes, dosje personale me dokumentet përkatëse sipas ligjit?

4. Sa është numri I fëmijëve të larguar nga këto qendra rezidenciale për vitin 2012?

Sipas : - Grupmoshës

-Arsyes së largimit

5. A interesohen prindërit e fëmijëve shpesh pranë institucionit tuaj ?

6. A janë prindërit e fëmijëve të interesuar dhe bashkëpunues në zhvillimin e tyre intelektual? Cilat janë politikat që ndjek institucioni juaj për afrimin e fëmijëve me prindërit e tyre ?

7. A mbështeten e përgatiten këta fëmijë për tu larguar nga qendra?

8. A behet monitorimi i vazhdueshëm pasi fëmija largohet nga përkujdesi?

9. A marrin fëmijët ushqime e lëngje sipas nevojave të tyre dietike e te moshës?

Stafi dhe fëmijët a i hane vaktet se bashku ?

10. A përfshihen fëmijët në marrjen e vendimeve për veshjen , prerjen e flokëve ?

11. A ka një plan individual për secilin fëmijë për kujdesin shëndetësor që nga lindja, ecurinë e sëmundjeve , alergjitë etj? A kanë akses te shërbimet e specializuara për AK ? A bëhen vizita mjekësore periodike për këta fëmijë ? Ku vizitohen këta fëmijë ? A ka shërbim mjekësor të

vendosur ne këtë qendër? Cilat janë problematikat shëndetësore të cilat prekin më shume Fëmijët ? Vaksinohen rregullisht Fëmijët ?

12. A nxitet edukimi te fëmijët? A ka mjedis studimi, biblioteke ? A kanë këta fëmijë materialet e nevojshme shkollore? Sa nga këta fëmijë frekuentojnë shkollën ? Në cilën shkollë shkojnë ? Si janë rezultatet në mësimet të këtyre nxënësve ? A pranohen lehtësisht këta fëmijë në klasë nga mësuesit dhe shokët ? PSE JO ?

13. Si organizohet koha e lire për këta fëmijë? A organizohen lodra , diskutime me tema edukative etj?

14. A pranohet nga ana e stafit ankesa, sugjerime nga këta fëmijë ? Cilat kane qene sugjerimet e fundit nga fëmijët?

16. A ka një kod sjelle sipas të cilit duhet të jetë trajnuar personeli?

17. A ofron shtëpia kushtet e saj të përshtatshme për këta fëmijë ? A ka lehtësi në përdorimin e mjediseve të saja ?Sa është numri i fëmijëve në një dhomë? Sistem ngrohje? Si janë kushtet e tualeteve ?

18. Cili është viti i ndërtimit të kësaj qendre? Cili është viti i fundit që kjo qendër është ri-konstruktuar?

19. Çfarë ndodh me këta fëmijë pas moshës 14 vjeç ? Çfarë lehtësime social i ofrohet nga institucioni juaj ? Sa mbështeten këta fëmijë nga institucionet lokale ?

20. Ndjehen te barabarte ne ambientet publike, shëndetësore etj këta fëmijë ?
Sa të përfshire janë në aktivitete dhe veprimtari të ndryshme?

21. Çfarë mund te behet me shume ne lidhje me përfshirjen sociale për këta fëmijë?

22. Sa është Buxheti i shpenzuar në nivel lokal për vitin 2012 për Fëmijët jashtë kujdesit Prindëror?